

VENDIM
Nr. 6, datë 10.3.2014

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK PËR SHA UK LUSHNJË QYTET

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr. 8102, datë 21.3.1996 “Për kudrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, metodologjisë “Për vendosjen e tarifave”, si dhe vendimit të KKRR-së nr. 35, datë 14.10.2013 “Për miratimin e përqindjes së pagesës rregullatore për vitin 2014”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave të sh.a. UK Lushnjë-qytet

a) Tarifë volumetrike për shërbimet:

	Furnizimi me ujë	Largimi i ujërave të ndotura
Konsumator familjar	54 lekë/m ³	15 lekë/m ³
Institucione buxhetore	125 lekë/m ³	20 lekë/m ³
Ente private	135 lekë/m ³	22 lekë/m ³

b) Tarifë fikse

Konsumator familjar	100 lekë/muaj/klient
Institucione buxhetore	200 lekë/muaj/klient

c) Shitje uji me shumicë 32 lekë/m³

2. Objektivat e treguesve kryesorë të performancës për vitin 2014

- uji pa të ardhura (humbjet)	65%
- niveli i matjes	99%
- kohëzgjatja e furnizimit	8 orë/ditë
- efienca e energjisë	0.58 kWh/ m ³
- efikasiteti i stafit	5.9 p/000/lidhje
- mbulimi me ujë	85%
- mbulimi me kanalizime	70%
- norma e arkëtimit	85%
- cilësia e ujit (klor+koliform)	Sipas standardeve

3. Pagesa rregullatore vjetore për sh.a. Lushnjë-qytet do të jetë 0.8% e të ardhurave të llogaritura.

4. Ky vendim hyn në fuqi, më 1.4.2014, dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

5. Vendimi i KKRR-së nr. 102, datë 7.1.2013 “Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik”, shfuqizohet.

KRYETAR
Avni Dervishi